



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-172441

Dt. 27.12.2023

Prizren

**DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR**, me kërkesën e HAB GROUP SH.P.K.-Gjakovë me të cilën kanë kërkuar leje për ndërtimin e objektit **Afaristo-banesor** bazuar në nenin 3 alineja 1 pikat 1.7, 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alineja 1 pika 1.1, nenin 15 alineja 1 pika 1.1, neni 18 e lidhur me dhe nenin 19 pika 2 të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013, si dhe konform neneve 14,15,16,17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, si dhe konform nenit 4 pika 6.1, paragrafi 2 dhe paragrafi 14 si dhe pika 6.3 e Rregullores për taksa,tarifa,ngarkesa dhe gjoha nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.01/011-46063 dt.28.03.2019, si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe neneve 125 dhe 127 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 me Nr. 001-011-48192, të datës 31.03.2022, merr këtë:

**VENDIM**  
**(për Leje Ndërtimore)**

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	<b>HAB GROUP SH.P.K.</b>		
Adresa:	<b>U.Ç.K p.n. Gjakovë</b>		
Telefoni:		Emaili:	

Emri i projektit	<b>Objekti – Afaristo-banesor</b>
Emri i projektuesit	<b>Byroja projektuese LAND Studio SH.P.K.</b>
Adresa:	<b>Perandori Doklician nr.7 -Prishtinë</b>

Telefoni:	049 890 913	Emaili:	landstudioo@gmail.com
-----------	-------------	---------	-----------------------

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore HAB GROUP SH.P.K. me seli në Gjakovë, i lejohet ndërtimi i objektit-Afarist dhe banesor në rrugën " Tranziti i Ri " Zona Kadastrale Prizren.

Për punët ndërtimore në vijim		
Adresa: ZK Prizren		
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Prizren, kurse në bazë të HZK-së është në zonën ZSHP-1. Objekti – Afarist dhe banesor do të ndërtohet në parcelat nr.P-71813068-05091-18;P-71813068-05091-16;P-71813068-05091-17 dhe P-71813068-11620-0 Z.K.Prizren me sipërfaqe të tërësishme 3744m <sup>2</sup> (në bazë të certifikatave të pronës). Sipërfaqja bruto e bodrumit është S=2664.50m <sup>2</sup> Sipërfaqja bruto e përdhësës është S=1496.40m <sup>2</sup> . Sipërfaqja bruto e kateve mbi përdhese është S=9732.10m <sup>2</sup> Sipërfaqja bruto e objektit është S=13893.00m <sup>2</sup> Sipërfaqja neto për pagës e objektit është S=8783.00m <sup>2</sup> Etazhiteti i objektit do të jetë <b>B+P+6+PH;B+P+6;B+P+5+PH;B+P+5;B+P+4</b>	GPS Koordinatat:

- Është miratuar kisti i parë i taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej **29 366.02 (40%)** nga shuma e përgjithshme për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej **73 415.04€**. Ndërtimi i lejuar sipas kistit të parë është në bazë të vlerës së pagesës. Punimet në vazhdim mund të zhvilloj sipas kësteve të miratuara, **në të kundërtën pezullohet vazhdimi i ndërtimit.**
- Paralogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **2,484,700.65 €**.

Lloji i ndërtimit të propozuar: Ndërtimi i ri <input checked="" type="checkbox"/> Rindertim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndertimeve te propozuera: Kategoria II



A perfshin kërkesa ndryshimin e destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Perdorimi i propozuar i objektit –Afarist dhe banesor

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore HAB GROUP SH.P.K. me seli në Gjakovë, i lejohet ndërtimi i objektit – Afarist dhe banesor **me etazhitet B+P+6+PH;B+P+6;B+P+5+PH;B+P+5;B+P+4**

### Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
  - Informata mbi Lejen Ndërtimore
  - Informatat mbi projektuesin
  - Informata mbi kontraktuesin
  - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
  - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
  - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
  - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
  - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
  - Kartelën e miratuara nga Drejtoria e Inspekcionit – inspektorati i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
  - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;